

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(së bashku me raportin e audituesit të pavarur)

Contents

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e pozicionit financiar	7
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit	8
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	9
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	10 - 119

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtimit të Alpha Bank Albania Sha,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Alpha Bank Albania SHA. (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Bankës në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetimin, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania SHPK

Deloitte Audit Albania SHPK

Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 7, 1010,

Tirana, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara

Partner Angazhimi

Auditues ligjor



28 korrik 2021

Tiranë, Shqipëri

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(shumat në LEK'000)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga interesat	6	2,236,650	2,371,820
Shpenzime për interesat	6	(311,462)	(388,297)
Të ardhura neto nga interesat		1,925,188	1,983,523
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	7	470,158	489,423
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	7	(44,531)	(59,578)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet		425,627	429,845
Humbje neto nga transaksionet financiare	8A	118,672	(28,170)
Të ardhura të tjera operative	8B	68,359	49,585
Të ardhurat totale		2,537,846	2,434,783
Shpenzime personeli	9	(731,802)	(737,008)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	16, 17	(303,825)	(281,286)
Shpenzime operative	10 A	(1,179,738)	(1,062,390)
Shpenzime të tjera	10 B	(76,144)	(16,993)
Totali i shpenzimeve operative		(2,291,509)	(2,097,677)
Humbja neto nga zhvlerësimi për huatë	15	(135,001)	(199,088)
Fitim/ (Humbja) para tatimit		111,336	138,018
Kreditimi/ (shpenzimi) i tatimi mbi fitimin	11	-	-
Fitim/ (Humbja) e vitit		111,336	138,018
Të ardhura / (shpenzime) të tjera gjithëpërfshirëse:			
Zëra që mund të klasifikohen në fitim ose humbje			
Rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	14	(58,124)	260,128
Të ardhura/(shpenzime) të tatimit të shtyrë	11	8,719	(39,019)
Rivlerësimi i aktiveve financiare neto, neto nga tatimit		(49,405)	221,109
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(49,405)	221,109
Totali i të ardhurave/ (humbjeve) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		61,931	359,127

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 10 deri në faqen 119, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyra e pozicionit financiar

(shumat në LEK'000)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Aktivët			
Mjetet monetare dhe balancat me Bankën Qendrore	12	8,827,452	8,837,253
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	13	11,830,779	14,088,526
Aktive financiare:	14		
- Të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	14	19,985,089	16,249,370
- Të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)	14	-	1,224,850
Hua dhe paradhënie klientëve	15	33,585,947	35,007,564
Aktive afatgjata materiale, neto	16	1,711,443	1,829,268
Aktive afatgjata jomateriale, neto	17	89,862	61,151
Tatim fitim i parapaguar	20	24,661	20,579
Aktive të tjera	18	327,645	301,331
Aktive të riposeduara	19	588,700	716,201
Totali i Aktiveve		76,971,578	78,336,093
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	21	1,060,001	1,462,740
Detyrime ndaj klientëve	23	62,930,067	63,845,679
Borxh i varur	24	1,981,790	1,951,178
Detyrime tatimore të shtyra	11	138,715	147,434
Detyrime të tjera	25	1,778,015	1,908,003
Totali i detyrimeve		67,888,588	69,315,034
Kapitali			
Kapitali aksionar	26	10,960,120	10,960,120
Rezerva rregullatore	27	817,483	817,483
Rezerva të tjera	26	542,864	592,269
Humbja e akumuluar		(3,237,477)	(3,348,813)
Totali i Kapitalit		9,082,990	9,021,059
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		76,971,578	78,336,093

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Alpha Bank Albania SHA më 26 korrik 2021 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Georgios Papanastasiou

Drejtör i Përgjithshëm

Enita Shallo

Menaxher i departamentit të Financës dhe Kontabilitetit

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 10 deri në faqen 119, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

(shumat në LEK'000)

Shënime	Kapitali aksionar	Rezerva rregullatore	Rezerva të tjera	Humbje të mbartura	Totali
Balanca më 1 janar 2019	10,960,120	817,483	371,160	(3,486,831)	8,661,932
Fitimi i vitit	-	-	-	138,018	138,018
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj	26	-	221,109	-	221,109
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	221,109	138,018	359,127
Balanca më 31 dhjetor 2019	10,960,120	817,483	592,269	(3,348,813)	9,021,059
Fitimi i vitit	-	-	-	111,336	111,336
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj	26	-	(49,405)	-	(49,405)
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(49,405)	111,336	61,931
Balanca më 31 dhjetor 2020	10,960,120	817,483	542,864	(3,237,477)	9,082,990

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 10 deri në faqen 119, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyra e flukseve monetare

(shumat në LEK'000)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operacional</i>			
Humbja para tatimit		111,336	138,018
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësim dhe amortizim	16,17	303,825	281,286
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(182)	(1,342)
Aktive afatgjata materiale të çrregjistruara	16	199	9,083
Humbje nga zhvlerësimi dhe provizionimi i kredive dhe paradhënies ndaj klienteve për te mbuluar rrezikun kreditor	15	132,765	288,032
Zhvlerësimi i instrumentave financiare		43,455	15,839
E ardhur e perealizuar e aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		(19,749)	(17,127)
Të ardhura nga interesat	6	(2,236,650)	(2,371,820)
Shpenzime interesi	6	311,462	388,297
Fluksi neto nga aktiviteti operacional		(1,353,539)	(1,269,734)
(Rritje) e rezervës së detyrueshme	12	163,315	(120,597)
(Rritje) e kredisë dhe paradhënies për klientët		1,439,030	(195,319)
(Rritje) e aktiveve të tjera	18	138,944	(45,696)
Rritje /(Rënie) e detyrimeve ndaj bankave	21	(425,887)	(2,496,837)
Rritje /(Rënie) e detyrimeve ndaj klientëve	24	(1,341,178)	2,485,421
Rritje /(Rënie) e detyrimeve të tjera	26	(34,023)	12,503
Interesi i paguar		(262,968)	(345,382)
Interesi i arkëtuar		2,386,694	2,524,634
Fluksi neto (nga) / përdorur në aktivitetin operacional		710,388	548,993
<i>Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues:</i>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	16,17	(214,911)	(77,799)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		182	1,342
Të ardhura nga shitja / maturimi i instrumentave financiare		2,695,212	4,705,613
Blerje e instrumentave financiare		(5,318,985)	(5,141,893)
Fluksi neto (përdorur në) / nga aktiviteti investues		(2,838,502)	(512,737)
<i>Fluksi monetar nga aktiviteti financues</i>			
Shlyerje e borxhit të varur		(32,323)	(33,052)
Shlyerje e qirasë financiare		(212,810)	(165,985)
Fluksi neto përdorur në aktivitetin financues		(245,133)	(199,037)
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		269,014	(150,699)
(Rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të saj		(2,104,233)	(313,480)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit		16,048,608	16,362,088
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit	28	13,944,375	16,048,608

Pasqyra e fluksit monetar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 10 deri në faqen 119, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

1. Të përgjithshme

Alpha Bank S.A – Dega Tiranë u themelua më 1998 si Alpha Bank S.A, Athinë (“Zyra Qëndrore”), e cila është kompania mëmë e shoqërive të Alpha Bank S.A. Në 19 Dhjetor 2006, Bordi Drejtues i Zyrës Qëndrore aprovoi ndryshimin e emrit të Bankës në Alpha Bank – Albania (“Banka”). Zyrat qëndrore të Bankës gjenden në Rrugën e Kavajës, G – Kam Business Center, kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri.

Në 29 Shkurt 2012, Banka u transformua në një filial, bazuar në vendimin nr.14 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe u liçensua për të kryer transferta pagesash, aktivitete kreditimi dhe mbajtje depozitash, si edhe aktivitete të tjera sipas ligjit Nr.8365, datë 2 Korrik 1998 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i amenduar në 18 Dhjetor 2006 dhe ligjit Nr.8269, datë 23 Dhjetor 1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë”, dhe ndryshoi emrin në Alpha Bank Albania SHA.

Kompania Mëmë e bankës është Alpha International Holdings Single Member SA. Kompania mëmë kontrolluese përfundimtare e bankës është Alpha Bank S.A. Për detaje të mëtejshme të strukturës së aksionarëve referojuni shënimit 31.

Banka ka 34 degë në të gjithë vendin (2019: 33 degë), nga të cilat 12 ndodhen në Tiranë (2019:11 degë)

Këshilli Drejtues i bankës sic është përcaktuar në statutin dhe kuadrin ligjor përkatës është një nga organet më të rëndësishme drejtuese të bankës dhe përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Roli/pozicioni		Emri
Kryetar	Jo-ekzekutiv	Christos Giampanas
Nën kryetar	Jo-ekzekutiv	Konstantinos Dorkofikis
Anëtar	I pavarur	Ilir Ciko
Anëtar	I pavarur	Tatjana Elezi
Anëtar	I pavarur	Ioannis Parlitsis
Anëtar	Ekzekutiv	Georgios Papanastasiou
Anëtar	I pavarur	Stavri Pashko

Komiteti i Auditimit mbikëqyr përgatitjen dhe publikimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Bankës dhe të Grupit, si dhe auditimet e brendshme dhe të jashtme të Bankës. Komiteti auditimit është i përbërë nga pjestarët e mëposhtëm:

Roli/pozicioni	Emri
Kryetar	Stavri Pashko
Anëtar	Tatjana Elezi
Anëtar	Georgios Kontogiannis

2. Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare lidhen me vitin fiskal nga 1 janar 2020 deri në 31 dhjetor 2020 dhe janë të përgatitura:

- në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).
- sipas parimit të kostos historike, përveç disa aktiveve dhe detyrimeve të cilat janë matur sipas parimit të Vlerës së Drejtë. Këto aktive janë kryesisht si më poshtë:
 - Instrumente financiare derivative
 - Aktive investuese të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
 - Aktive investuese të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme për të marrë parasysh kushtet aktuale, dhe efekti i çdo rishikimi njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, të rrumbullakosura në mijëshe, përveç se nëse shprehet ndryshe.

Vlerësimet dhe gjykimet e zbatuara nga Banka në përgatitjen e pasqyrave financiare bazohen në informacionet historike dhe supozimet të cilat ne periudhën që ndodhin konsiderohen si të përshtatshme.

3. Adoptimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

3.1 Standartet dhe interpretimet efektive ne periudhën raportuese aktuale

► Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një biznesi (Rregullore 2020/551/21.4.2020)

Më 22.10.2018, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit paraqiti një ndryshim në SNRF 3 që synonte zgjidhjen e vështirësive që dalin kur një njësi përcakton nëse ka blerë një biznes apo një grup pasurish. Ndryshimet:

- qartësimi i kërkesave minimale të kërkuara në mënyrë që të merret një biznes
- vlerësimi për blerjen ose të një biznesi, ose të një grupi të aktiveve është i thjeshtuar dhe është i bazuar në kushtet aktuale të elementeve të përfutuara në vend të aftësisë së pjesëmarrësit në treg për t'i integruar në proceset e tij,
- përkufizimi i daljeve ndryshohet në mënyrë që përveç të ardhurave të dala nga veprimtaritë e zakonshme që bien brenda gamës së SNRF 15, të përfshihen gjithashtu të ardhura të tjera nga veprimtaritë kryesore të tilla si të ardhurat nga shërbimet e investimeve,
- udhërrëfyeni është shtuar për të vlerësuar nëse një proces prodhimi është thelbësor si në rastet ku prodhohet një prodhim në datën e blerjes dhe në rastet ku nuk prodhohet asnjë prodhim,
- një ushtrim opsional është futur bazuar në vlerën e drejte të aktiveve të fituara për të vlerësuar nëse është marrë një biznes apo grup aktivesh.

Miratimi i ndryshimeve të mësipërme nuk pati ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimi në "Instrumente Financiare" në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9, në "Instrumente Financiare" në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 dhe në "Instrumente Financiare: Shenime Shpjeguese : Reforma e nivelit të interesit" në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7. Rregullore 2020/34/15/1/2020)

Më 26.9.2019, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit lëshoi ndryshime në SNRF 9, IAS 39 dhe SNRF 7, sipas të cilave përjashtimet e përkohshme nga aplikimi i kërkesave të posaçme të kontabilitetit mbrojtës ofrohen në kontekstin e reformës standarte të normave të interesit.

Në përputhje me përjashtimet, njësitë që aplikojnë këto kërkesat e kontabilitetit të mbrojtës mund të supozojnë se niveli i interesit nuk ndryshohet si rezultat i reformës standarte të nivelit të interesit. Është siguruar lehtësimi lidhur me kërkesat vijuese:

- kërkesa me propabilitet të lartë të mbrojtjes të fluksit të mjeteve monetare
- vlerësime të mundshme,
- përcaktimi i një elementi si një element mbulues vetëm në konceptimin e marrëdhënies mbrojtëse

Miratimi i ndryshimit të mësipërm nuk pati ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 "Qiratë": Konçesionet e qirasë të lidhura me Covid-19 (Rregullore 2020/1434/9.10.2020)

Në 28.10.2020, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit lëshoi amendamentin ndaj SNRF16 lidhur me trajtimin e konçesioneve të qirave që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e epidemisë Covid-19.

Sipas këtij ndryshimi, një qirramarres mund të zgjedhë (mjet praktik) për të mos vlerësuar nëse një koncesion qiraje është një modifikim. Mjeti praktik është aplikuar për çdo reduktim në pagesat me qira që prekin vetëm pagesat që priten në ose përpara 30 qershorit 2021.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3. Adoptimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara (vazhdim)

3.1 Standartet dhe interpretimet efektive ne periudhën raportuese aktuale (vazhdim)

Nëse mjeti praktik aplikohet, supozohet se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim me qira dhe e pakta mund të llogarisë për koncesionin si një pagesë negative për dhënien me qira të ndryshueshme, duke njohur pagesën e ndryshueshme në deklaratën e humbjes së fitimit dhe duke bërë një përshtatje korresponduese me përgjegjësinë e qirasë.

Mjeti praktik i sipërpërmendur nuk është i aplikueshëm për qiramarresit, të cilët vazhdojnë të zbatojnë kërkesat ekzistuese të Standardit.

Miratimi i ndryshimeve të mësipërm nuk ishte i aplikueshëm në Shqipëri.

Ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimit i materialitetit" (Rregullore 2019/2104/29.11.2019)

Më 31.10.2018, Bordi i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit, si pjesë e Iniciativës për Gjetje, lëshoi ndryshime për IAS 1 dhe IAS 8 për ta barazuar përkufizimin e 'materialitetit' përmes standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përcaktimit.

Përcaktimi i ri pohon se informacioni është material në qoftë se heqja, keqdeklarimi ose fshehja e tij, logjikisht mund të pritë të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të qëllimit të përgjithshëm, bëjnë mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion financiar rreth një njësie specifike raportuese. Ndryshimet përfshijnë shembuj të rrethanave që mund të rezultojnë në fshehjen e informacionit material. BSNK gjithashtu ka ndryshuar përkufizimin e materialit në Kuadrin Konceptual për ta harmonizuar atë me përkufizimin e rishikuar të materialit në SNK 1 dhe SNK 8.

Miratimi i ndryshimit të mësipërm nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në referencat në kuadrin konceptual në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (Rregullore 2019/2075/29.11.2019)

Më 29.3.2018, Bordi i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit lëshoi një Kuadër Konceptual për Raportimin Financiar, i cili u përdor menjëherë nga Bordi dhe Komiteti i Interpretimeve në lëshimin e Standardeve dhe Interpretimeve të reja dhe u bë efektiv për përgatitjen e Pasqyrave Financiare për periudha vjetore duke filluar nga 1 janari 2020. Korniza Konceptuale e rishikuar përfshin a) kapituj të rinj për shtimin e udhëzimeve në lidhje me matjen, çregjistrimin, prezantimin dhe zbulimin dhe përcaktimin e njësisë raportuese, b) përditësimin e përcaktimit për aktivet dhe detyrimet dhe kriteret e njohjes dhe c) sqarime në lidhje me domosdoshmërinë e informacionit për administrimin e informacionit për të përmbushur objektivin e raportimit financiar, si dhe rolet e maturisë, pasigurisë së matjes dhe përmbajtjes mbi formën në vlerësimin nëse informacioni është i dobishëm.

Së bashku me Kornizën Konceptuale të rishikuar, BSNK ka lëshuar gjithashtu Ndryshime në referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e referencave të lidhura me Kornizën Konceptuale të rishikuar. Kuadri Konceptual nuk i zëvendëson kërkesat e Standardeve të SNRF-së, por përdoret nga Ndërmarrja për të ndihmuar zhvillimin e politikave konsekuente të kontabilitetit për transaksionet ose ngjarjet e tjera kur nuk aplikohet Standardi.

Miratimi i ndryshimeve të mësipërme nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3. Adoptimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara (vazhdim)

3.2 Standardet e lëshuara por jo ende efektive dhe jo të miratuara herët

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por jo ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Bankës shpalosen më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 4 "Kontratat e Sigurimit" Zgjatja e përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 (Rregullorja 2020/2097 / 15.12.2020):

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2021

Më 25.6.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNRF 4 me të cilin zgjati përjashtimin e përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 me dy vjet. Në këtë kontekst, kompanitë që kanë përdorur përjashtimin e përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 do të zbatojnë standardin deri në 1.1.2023.

Ndryshimi i mësipërm nuk është i aplikueshëm për pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 "Instrumentet Financiare", në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja", në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7 "Instrumentet Financiare: Gjetjet", në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16 "Qira": Reforma referuese e normës së interesit - faza 2 (Rregullorja 2021/25 / 13.1.2021)

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2021

Më 27.10.2020, Bordi Ndërkombëtar i Standardit të Kontabilitetit lëshoi ndryshime në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 në kontekstin e Fazës 2 të projektit IBOR që adresojnë çështje që lindin pas reformës së një norme referimi të normës së interesit, përfshirë zëvendësimin e një norme referimi me një alternative. Lehtësimet kryesore të dhëna nga ndryshimet e Fazës 2 janë si më poshtë:

- Ndryshimet në fluksin e parave të kontraktuara. Kur ndryshon bazën për përcaktimin e flukseve monetare kontraktuale për aktivet dhe pasivet financiare (përfshirë detyrimet e qirasë), lehtësimet kanë efekt që ndryshimet që kërkojnë nga një reformë referuese e normës së interesit nuk do të rezultojnë në një fitim ose humbje të menjëhershme në pasqyrën e të ardhurave por në rrillogaritjen e normës së interesit. E njëjta gjë praktike vlen për siguruesit që po përdorin përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9.
- Kontabiliteti mbrojtës. Lehtësimet e kontabilitetit mbrojtës sigurojnë që ndryshimet në dokumentacionin mbrojtës nuk rezultojnë në ndërprerjen e kontabilitetit mbrojtës ose përcaktimin e një marrëdhënie të re mbrojtëse, për sa kohë që ndryshimet e vetme janë ato të lejuara nga Ndryshimet e Fazës 2. Ndryshimet e lejuara përfshijnë ripërcaktimin e rrezikut të mbrojtur për të referuar një normë pa rrezik dhe ripërcaktimin e përshkrimit të instrumenteve mbrojtës dhe / ose artikujve të mbrojtur për të pasqyruar normën pa rrezik. Sidoqoftë, joefektiviteti shtesë mund të duhet të regjistrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Banka po shqyrton ndikimin nga miratimi i ndryshimeve të mësipërme në pasqyrat e saj financiare.

Për më tepër, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka nxjerrë standardet e mëposhtme dhe ndryshimet në standarde të cilat nuk janë miratuar ende nga Bashkimi Evropian dhe ato nuk janë zbatuar herët nga Banka.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 3 "Kombinimet e Biznesit": Referenca në Kuadrin Konceptual - Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2022

Më 14.5.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ndryshoi SNRF 3 në mënyrë që të azhurnojë referencat në Kuadrin Konceptual. Më specifikisht:

- ndryshoi SNRF 3 në mënyrë që t'i referohej versionit më të fundit të Kuadrit Konceptual,
- shtoi një kërkesë që për transaksionet brenda fushës së SNK 37 ose KIRFN 21 një blerës të zbatojë SNK 37 ose KIRFN 21 në vend të Kornizës Konceptuale për të identifikuar detyrimet që ka marrë në një kombinim biznesi,
- shtoi një deklaratë të qartë se një blerës nuk njeh aktive të kushtëzuara të blera në një kombinim biznesi.

Miratimi i ndryshimit të mësipërm nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3.2 Standardet e lëshuara por jo ende efektive dhe jo të miratuara herët (vazhdim)

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 10 “Pasqyrat e Konsoliduara Financiare” dhe në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 28 “Investimet në Shoqëritë e Ndërmarrjeve të Përbashkëta”: Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe një shoqërie të përbashkët ose ndërmarrje të përbashkët. - Data efektive: Për t'u përcaktuar

Më 11.9.2014, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim për SNRF 10 dhe IAS 28 me qëllim që të qartësojë trajtimin e kontabilitetit të një transaksioni të shitjes apo kontributit të aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij të përbashkët apo sipërmarrjes së përbashkët. Në veçanti, SNRF 10 u ndryshua me qëllim që të sqarohet se në rast se si rezultat i një transaksioni me një ndërmarrje aksionere apo një sipërmarrje të përbashkët, një dege mëmë (investitor) humbet kontrollin e një dege, e cila nuk përbën një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, do të njohë në fitim ose humbje vetëm pjesën e fitimit apo humbjes që nuk lidhet me sipërmarrjen e përbashkët të investitorëve apo të lidhur me këto interesa.

Pjesa e mbetur e fitimit nga transaksioni do të eliminohet përkundrejt vlerës kontabël të investimit në atë ndërmarrje të përbashkët. Për më tepër, në rast se investitori mban një investim në ish-filialin dhe ish-filiali është tani një pjesëmarrje ose ndërmarrje e përbashkët, ai njeh pjesën e fitimit ose humbjes që rezultojnë nga rmatja me vlerën e drejtë të investimit të mbajtur në atë ish-filial në fitimin ose humbjen e tij vetëm në masën e interesave të investitorit të palidhur në shoqërinë e re ose ndërmarrjen e përbashkët. Pjesa e mbetur e fitimit eliminohet përkundrejt vlerës kontabël të investimit të mbajtur në ish-filialin.

Në SNK 28, përkatësisht, u sqarua se njohja e pjesës së fitimeve ose humbjeve do të zbatohet vetëm kur aktivet e përfshira nuk përbëjnë një biznes. Përndryshe, totali i fitimit ose humbjes do të njihet.

Më 17.12.2015, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit shtyu datën efektive për zbatimin e ndryshimit që ishte përcaktuar fillimisht. Data e re efektive do të përcaktohet nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në një datë të ardhshme pasi të marrë parasysh rezultatet e projektit të tij në lidhje me metodën e kapitalit.

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 14 “Llogaritë e shtyrjes rregullatore”

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2016

Më 30.1.2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nxori SNRF 14. Standardi i ri, i cili ka një fushë të kufizuar, adreson trajtimin e kontabilitetit dhe informacionet shpjeguese të kërkuara për llogaritë e shtyrjes rregullatore që mirëmbahen në përputhje me legjislacionin vendor kur një njësi ekonomike ofron normë të rregulluar mallra ose shërbime. Fusha e këtij standardi është e kufizuar në adoptuesit për herë të parë që njohën llogaritë e shtyrjes rregullatore në pasqyrat e tyre financiare në përputhje me GAAP-in e tyre të mëparshëm. SNRF 14 lejon këto njësi ekonomike të kapitalizojnë shpenzimet që njësitë ekonomike të rregulluara jo nga norma do të njihnin si shpenzime.

Është vërejtur se Bashkimi Evropian ka vendosur të mos nisë miratimin e këtij standardi dhe të presë për standardin përfundimtar. Standardi i mësipërm nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 17 “Kontratat e Sigurimit” dhe Ndryshimi i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 “Kontratat e Sigurimit”

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2023

Më 18.5.2017, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi SNRF 17 i cili zëvendëson SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit”. Në ndryshim nga SNRF 4, standardi i ri paraqet një metodologji të qëndrueshme për matjen e kontratave të sigurimit. Parimet kryesore në SNRF 17 janë si më poshtë:

Një entitet:

- identifikon si kontrata sigurimi ato kontrata nën të cilat njësia ekonomike pranon rrezik të konsiderueshëm sigurimi nga një palë tjetër (mbajtësi i policës) duke rënë dakord të kompensojë mbajtësin e policës nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt e ardhshme ndikon negativisht në mbajtësin e policës;
- ndan derivatet e specifikuar të ngulitura, përbërësit e veçantë të investimeve dhe detyrimet e veçanta të performancës nga kontratat e sigurimit;
- ndan kontratat në grupe që do të njohë dhe mat;

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3.2 Standardet e lëshuara por jo ende efektive dhe jo të miratuara herët (vazhdim)

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 17 “Kontratat e Sigurimit” dhe Ndryshimi i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 “Kontratat e Sigurimit” (vazhdim)

- njeh dhe mat grupet e kontratave të sigurimit në:
 - i. një vlerë aktuale e rregulluar e rrezikut e flukseve të ardhshme të parasë (përmbushja e flukseve të parasë) që përfshin të gjithë informacionin e disponueshëm në lidhje me përmbushjen e flukseve të parasë në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e tregut të vëzhgueshëm; plus (nëse kjo vlerë është një pasiv) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv)
 - ii. një shumë që përfaqëson fitimin e pa fituar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual);
- njeh fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që njësia ekonomike ofron mbulim të sigurimit dhe ndërsa njësia ekonomike lirohet nga rreziku. Nëse një grup kontratash është ose bëhet humbës, një njësi ekonomike njeh humbjen menjëherë;
- paraqet veçmas të ardhurat e sigurimeve, shpenzimet e shërbimit të sigurimeve dhe të ardhurat ose shpenzimet e financave të sigurimeve; dhe
- zbulon informacione për t'u dhënë mundësi përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektin që kanë kontratat brenda fushës së SNRF 17 në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parave të një njësie ekonomike.

Më 25.6.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNRF 17 i cili synonte të lehtësonte zbatimin e standardit dhe të bënte më të lehtë për njësitë ekonomike për të shpjeguar performancën e tyre financiare. Për më tepër, me ndryshimin, data e hyrjes në fuqi e standardit u shty për 1.1.2023.

Standardi i mësipërm nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare": Klasifikimi i detyrimeve si korente ose jo-korente

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2023

Më 23.1.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi ndryshime në SNK 1 në lidhje me klasifikimin e pasiveve si aktuale ose jo-korente. Më specifikisht:

- Ndryshimet specifikojnë që kushtet të cilat ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit janë ato që do të përdoren për të përcaktuar nëse pasivi duhet të klasifikohet si aktual ose jo-aktual.
- Pritjet e bordit drejtues për ngjarjet pas datës së bilancit nuk duhet të merren parasysh.
- Ndryshimet sqarojnë situatat që konsiderohen shlyerje të një detyrimi.

Më 15.7.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit zgjati datën efektive me një vit duke marrë parasysh ndikimin e Covid-19.

Ndryshimi i mësipërm nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës meqenëse në bilancin e detyrimeve të Bankës ato nuk klasifikohen si korente dhe jo-korente.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”: Shpalosja e politikave të kontabilitetit

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2023

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3.2 Standardet e lëshuara por jo ende efektive dhe jo të miratuara herët (vazhdim)

Më 12.2.2021, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNK 1 me të cilin sqaroi se:

- Përkufizimi i politikave të kontabilitetit sigurohet nga paragrafi 5 i SNK 8.
- Një njësi ekonomike duhet të zbulojë informacionin e politikës materiale të kontabilitetit. Informacioni i politikës së kontabilitetit është material nëse, kur konsiderohet së bashku me informacionin tjetër të përfshirë në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, mund të pritët që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare bëjnë.
- Informacioni i politikës kontabël që ka të bëjë me transaksione jomateriale është jomaterial dhe nuk ka nevojë të pasqyrohet si gjetje. Informacioni i politikës së kontabilitetit mund të jetë megjithatë material për shkak të natyrës së transaksioneve përkatëse edhe nëse shumat janë të parëndësishme. Sidoqoftë, jo të gjitha informacionet e politikave të kontabilitetit në lidhje me transaksionet materiale dhe ngjarjet e tjera janë vetë materiale.
- Informacioni i politikës së kontabilitetit është material nëse përdoruesit e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike do të kishin nevojë për të për të kuptuar informacione të tjera materiale në pasqyrat financiare.
- Informacioni i politikës së kontabilitetit që përqendrohet në mënyrën se si një njësi ekonomike ka zbatuar një politikë kontabël është më e dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare sesa informacioni i standardizuar ose informacioni që përmbledh vetëm kërkesat e SNRF-ve.
- Nëse një njësi ekonomike shpalos informacione jomateriale të politikës së kontabilitetit, një informacion i tillë nuk duhet të fshehë informacionin material të politikës së kontabilitetit.

Banka po shqyrton ndikimin nga miratimi i ndryshimit të mësipërm në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet": Përkufizimi i vlerësimeve të kontabilitetit

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2023

Më 12.2.2021, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNK 8 me të cilin:

- përcaktoi vlerësimet e kontabilitetit si shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë së matjes.
- sqaroi se një politikë kontabël mund të kërkojë që zërat në pasqyrat financiare të maten në një mënyrë që përfshin pasigurinë e matjes. Në një rast të tillë, një njësi ekonomike zhvillon një vlerësim të kontabilitetit. Zhvillimi i vlerësimeve të kontabilitetit përfshin përdorimin e gjykimeve dhe supozimeve.
- Një njësi ekonomike përdor teknikat dhe inputet e matjes për të zhvilluar një vlerësim të kontabilitetit.
- Një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të ndryshojë një vlerësim të kontabilitetit. Për nga natyra e tij, një ndryshim në vlerësimin e kontabilitetit nuk ka të bëjë me periudhat e mëparshme dhe nuk është korrigjimi i një gabimi. Një ndryshim në një input ose një ndryshim në një teknikë matjeje janë ndryshime në vlerësimet e kontabilitetit përveç nëse ato rezultojnë nga korrigjimi i gabimeve të periudhës së mëparshme.

Banka po shqyrton ndikimin nga miratimi i ndryshimit të mësipërm në deklaratat financiare të saj.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

3.2 Standardet e lëshuara por jo ende efektive dhe jo të miratuara herët (vazhdim)

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 “Aktive afatgjata dhe materiale”: Procedurat para përdorimit

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1.1.2022

Më 14.5.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNK 16, sipas të cilit ndalon zbritjen nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale, çdo pajisje nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa e sjell atë aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme për të të jetë i aftë të veprojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Në vend të kësaj, të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostoja e prodhimit të tyre duhet të njihen në fitim ose humbje.

Banka po shqyrton ndikimin nga miratimi i ndryshimit të mësipërm në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimi në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 37 “Detyrimet, detyrimet e kushtëzuara dhe pasuritë e kushtëzuara”: Kontratat e vështira - Kostoja e përbushjes së një kontrate

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 01.01.2022

Më 14.5.2020, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një ndryshim në SNK 37 në mënyrë që të sqarojë se kostoja e përbushjes së një kontrate përfshin kostot që lidhen drejtpërdrejt me kontratën. Këto kosto janë edhe kostot rritëse të përbushjes së një kontrate - për shembull punë direkte dhe materiale - dhe një alokim i kostove të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përbushjen e një kontrate - për shembull tarifa e amortizimit të një elementi të ndërtesave të pronës dhe pajisjeve të përdorura në përbushjen e asaj kontrata.

Banka po shqyrton ndikimin nga miratimi i ndryshimit të mësipërm në pasqyrat e saj financiare.

• Përmirësimet vjetore - cikli 2018-2020

Efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 01.01.2022

Si pjesë e projektit vjetor të përmirësimeve, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi në 14.5.2020 ndryshime jo urgjente, por të nevojshme në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41.

Ndryshimet e mësipërme nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës..

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit

Deklarata e përputhshmërisë

Deklaratat financiare të Alpha Bank Albania SHA janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF).

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të mëparshëm financiar.

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe monedha e vendit të themelimit të Bankës.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Bankës njihen me kurset e këmbimit mbizotëruese në datat e transaksioneve.

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën përkatëse funksionale të operacionit me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit mbyllës në datën e bilancit. Diferencat në valutë që vijnë nga përkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare që maten në terma të kostos historike në një valutë të huaj janë përkthyer duke përdorur normën e kursit të këmbimit në njohjen fillestare në datën e transaksionit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Kurset e zbatueshme të këmbimit (lekë në njësi të valutës së huaj) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor, 2020 dhe 2019 ishin si më poshtë:

	2020	2019
USD	100.84	108.64
EUR	123.70	121.77
GBP	137.93	143.00

(b) Instrumentet financiare - njohja fillestare dhe matja pasuese

(i) Data e njohjes

Të gjitha aktivet dhe pasivet financiare njihen fillimisht në datën kur Banka bëhet palë në provizionet kontraktuale të instrumentit.

(ii) Matja fillestare e instrumenteve financiare

Banka njeh aktivet financiare ose pasivet financiare në pasqyrën e saj të pozicionit financiar kur bëhet palë në kushtet e kontratës..

Në njohjen fillestare, Banka mat aktivet dhe pasivet financiare me vlera të drejta. Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit dhe minus të ardhurat ose tarifat që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të instrumentit financiar.

Blerjet në mënyrë të rregullt dhe shitjet e instrumentëve financiarë njihen në datën e zgjidhjes me përjashtim të aksioneve të barazisë dhe derivateve që njihen në datën e tregtisë. Për bonot që janë matur me vlerë të drejtë, ndryshimi në vlerë të drejte gjatë periudhës ndërmjet datës së emetimit dhe datës së zgjidhjes është i njohur në fitim ose në humbje ose në të ardhura të tjera tërësore bazuar në kategorinë e klasifikimit të bonos.

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivet financiare janë klasifikuar në kategoritë e specifikuar vijuese:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar
- Aktivet financiare të matura me vlerë të drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera tërësore, me fitimet apo humbjet e ricikluara në fitime apo humbje të regjistruara.
- Aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(b) Instrumentet financiare - njohja fillestare dhe matja pasuese (vazhdim)

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Për secilën nga kategoritë e mësipërme vlejnë si më poshtë:

A) Aktive financiare të matura me kosto të amortizuar

Në këtë kategori janë klasifikuar aktivet financiare që plotësojnë të dy kriteret e mëposhtme:

- aktivet financiare mbahen brenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve financiare me qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale,
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar japin në datat e specifikuara flukset e parave që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit (VPKI) mbi shumën e principalit të papaguar.

Kategoria e mësipërme matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe vlerësohet periodikisht për humbjet e pritura të kredisë, siç përshkruhet më tej në shënimin 16.

B) Aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me fitime ose humbje të ricikluara në fitim ose humbje nga mosnjohja

Në këtë kategori janë klasifikuar aktivet financiare që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- mbahen brenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare,
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar japin në datat e specifikuara flukset e parave që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit (VPKI) mbi shumën e principalit të papaguar.

Kategoria e mësipërme vlerësohet periodikisht për humbjet e pritura të kredisë, siç përshkruhet më tej në shënimin 14.

C) Aktivet financiare të matura me vlerë të drejte nëpërmjet fitimit apo humbjes

Aktivitetet financiare të përfshira në këtë kategori janë:

- ata të blera kryesisht për qëllimin e shitjes në afat të afërt për të marrë fitim afatshkurtër (të mbajtur për tregtim).
Banka ka përfshirë në këtë kategori bono, bono thesari dhe një numër të kufizuar aksionesh.
- ata që nuk përmbushin kriteret për t'u klasifikuar në një nga kategoritë e mësipërme
- ato të caktuara nga Banka, në njohjen fillestare, si me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Ky opsion i klasifikimit, i cili është i parevokueshëm, përdoret kur përcaktimi eliminon një mospërputhje kontabël e cila përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve dhe pasiveve financiare mbi një bazë të ndryshme (p.sh. kostoja e amortizuar) në lidhje me një aktiv ose pasiv tjetër financiar (dmth derivativët që maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes).

Në datën e raportimit, Banka nuk kishte përcaktuar, në njohjen fillestare, asnjë aktiv financiar si në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Për të ushtruar detyrat në mënyrë efektive, njësia ka të drejtë hyrje në të gjitha aktivitetet dhe njësitë, si dhe në të gjitha të dhënat e Bankës dhe informacione të tjera të nevojshme për të përmbushur detyrat e saj.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar, përveç rreziqeve të hasura nga Banka, edhe limitet e rrezikut dhe për të vendosur kontrole të përshtatshme për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e limiteve. Politikat e menaxhimit të rrezikut dhe procedurat rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe produktet e ofruara. Banka, nëpërmjet proceseve të vazhdueshme të trajnimeve ka për qëllim të zhvillojë një ambient të disiplinuar dhe kontrolluar në të cilin punonjësit i kuptojnë detyrat dhe rolet e tyre.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Një vështrim i përgjithshëm (vazhdim)

Struktura e Menaxhimit të Rrezikut të Alpha Bank S.A

Alpha Bank Albania është filial i Alpha Bank S.A dhe ndjek të njëjtën strategji për menaxhimin e rrezikut si Alpha Bank Grup, si një aktivitet i cili kryhet kudo njëjloj në Alpha Bank dhe është në të njëjtën linjë me standardet ndërkombëtare për të arritur një menaxhim rreziku sa më efektiv. Kultura e rrezikut është e ngulitur në të gjitha njësitë e biznesit nëpërmjet implementimit të Strukturës së Rrezikut të Alpha Bank Grup dhe iniciativave në pajtueshmëri me Strategjitë e Rrezikut të Grupit.

- Grupi i Alpha Bank angazhohet për arritjen e një kontrolli të fortë të mjedisit, si dhe një aftësi të veçantë për menaxhimin e rrezikut që u mundëson njësive të biznesit të përmbushin objektivat e tyre të performancës dhe për të arritur përmirësim të vazhdueshëm në fushën e menaxhimit të rrezikut. Alpha Bank Grup kryen vlerësime të rregullta të rrezikut për llojet e ndryshme të rrezikut dhe veçanërisht si pjesë e procesit të planifikimit strategjik dhe ndonjëherë edhe të projekt planeve.

Struktura e menaxhimit të rrezikut bazohet në parimet e mëposhtme:

- Struktura e menaxhimit të rrezikut drejtohet nga niveli i rrezikut të pranueshëm
- Struktura e menaxhimit të rrezikut është pjesë integrale e strategjisë së biznesit dhe e procesit të vendimmarrjes.
- Struktura e menaxhimit të rrezikut drejtohet nga përgjegjësia.
- Struktura e menaxhimit të rrezikut promovon transparencën nëpërmjet linjave të pastra të komunikimit.
- Personeli i përfshirë në drejtimin e Bankës ka rol aktiv në menaxhimin e rrezikut dhe zotëron aftësitë e nevojshme për ta menaxhuar atë në mënyrë efektive.
- Personeli i përcaktuar ka njohuri të mira të rolit dhe përgjegjësisë të tyre në kuadër të kornizës së menaxhimit të rrezikut.
- Të gjithë elementët, identifikimi i rrezikut, vlerësimi, monitorimi, raportimi, kontrolli dhe sistemet janë të dokumentuar mirë dhe informacioni i duhur, me anë të mekanizmave të raportimit u jepet niveleve të menaxhimit dhe njësive të biznesit.

Struktura e menaxhimit të rrezikut është dinamike, ajo evoluon vazhdimisht në përgjigje të ndryshimeve të objektivave strategjike dhe kushteve të brendshme (organizacionale dhe të biznesit) dhe të jashtme (tregu).

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti në kohë apo plotësisht. Ky rrezik vjen nga mundësia që një debitor nuk ka dëshirën të shlyejë detyrimet ose aftësia e tij për të shlyer detyrimin është përkeqësuar duke rezultuar në humbje ekonomike për Bankën. Veç kësaj, humbjet rezultojnë edhe nga pakësimi në vlerën e portofolit për shkak të përkeqësimit aktual ose të perceptuar të cilësisë së kredisë së huamarrësit.

Rreziku kreditor konsiderohet rreziku më i rëndësishëm për Bankën.

Banka njeh nevojën për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun e kredisë të qenësishëm në aktivitetet e saj të huadhënies me pakicë dhe shumicë, si edhe për të përcaktuar që Banka mban kapital të përshtatshëm për t'u mbrojtur nga rreziku dhe ky rrezik kompensohet në mënyrë të përshtatshme. Banka synon që të mbajë ekspozimet e rrezikut të kredisë brenda niveleve të pranueshme. Banka ka autorizuar dhe themeluar komitetet përkatëse për të mbikëqyrur rrezikun e kredisë. Komiteti i rrezikut është përgjegjës për mbikëqyrjen e kuadrit për menaxhimin e rrezikut të kredisë, Komiteti i themeluar Kreditor dhe Divizionet e Kredisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e aktiviteteve të lidhura me rrezikun e kredisë, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut janë përgjegjës për propozimin e politikave dhe procedurave të kredisë, Komiteti i Auditimit dhe Divizioni i Pavarur i Auditit të Brendshëm janë përgjegjës për t'u siguruar që praktikatat e rrezikut të kredisë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për aktivitetin e ndërmarrjes së rrezikut të kredisë.

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut siguron përputhshmërinë dhe monitoron zbatimin e politikave të rrezikut në përputhje me strategjinë e grupit dhe Bankës dhe në kërkesat e rregulloreve lokale. Komisioni i Auditimit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat e administrimit të rrezikut të Bankës dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i kontrollit ndihmohet në kryerjen e detyrave nga ana e Divizionit të Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr rishikime të rregullta të kontrolleve dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut dhe raporton rezultatet në Komitetin e Auditimit.

Banka, në mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun e kredisë ka zhvilluar metodologji specifike dhe sisteme për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun e kredisë. Këto sisteme dhe metodologji zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me zhvillimet makroekonomike, ligjore dhe rregullatore si edhe bazuar në zhvillimet strukturore dhe sektoriale të ekonomisë.

Mjete kryesore për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë nga huadhënia me shumicë dhe pakicë janë klasifikimi i rrezikut të kredisë, modelet e vlerësimit me pikë dhe sistemet e vlerësimit me faza. Sistemet e vlerësimit me faza, me pikë dhe të klasifikimit janë subjekt i kontrolleve të vazhdueshme të cilësisë për të siguruar në çdo kohë efektivitetin e tyre.

Vlefshmëria e modeleve të përdorura për matjen dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë së Bankës është në përputhje me Kuadrin e Vlerësimit të Modeleve të Rrezikut të Kredisë së Grupit, i cili bazohet në kuadrin mbikëqyrës dhe praktikatat më të mira. Gjatë vitit 2019, Banka ka vërtetuar në mënyrë cilësore dhe sasiore këto modele dhe i ka përmirësuar ato në përputhje me ndryshimet në mjedisin ekonomik dhe financiar.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Duhet përmendur që në vitin 2019, Banka duke njohur modelin e rrezikut të qenësishëm të modelit, që rrjedh nga kompleksiteti i modelit dhe rreziku i modelit të agreguar, ka adoptuar një kuadër të Modelit të Menaxhimit të Rrezikut, i cili përfshin parimet e politikës së zhvillimit të modeleve të rrezikut të kredisë dhe kuadrin e vlerësimit të modeleve të rrezikut.

Fazat e vlerësimit të huamarrësve

Huamarrësit janë kategorizuar sipas fazave të mëposhtëme:

AA, A+, A, A-, BB+, BB, BB-, B+, B, B-, CC+, CC, CC-, C, D, D0, D1, D2

Për qëllime të veçanta, modelet financiare të veçanta (Financim i Strukturuar dhe Transportues) janë dizenuar me kategorizimet e mëposhtëme:

I fortë (Klasa 1), Mirë (Klasa 2), Kënaqshëm (Klasa 3), Dobët (Klasa 4), Mospagim (Klasa 5).

Për qëllime paraqitje të tabelës “Huatë sipas cilësisë së kredisë dhe fazave SNRF9”, klasifikimi si “I fortë” përfshin fazat e kategorizimit AA, A+, A, A-, BB+ dhe BB dhe klasat 1 dhe 2, klasifikimi si “Kënaqshëm” përfshin fazat e kategorizimit BB-, B+, B, B-, CC+, CC dhe klasën 3, dhe “nën vëzhgim të kujdesshëm” (rrezik më i lartë) përfshin fazat CC-, C dhe klasën 4. Së fundmi, kategoria Mospagim, përfshin fazat e kategorive D, D0, D1, D2 dhe klasën 5.

Informacioni i së ardhmes në politikën e zhvlerësimit

- SNRF 9 kërkon që të shqyrtohen më shumë se një skenar për llogaritjen e ECL. Qasja e zbatuar sipas metodologjisë së Bankës është të ekzaminojë (3) skenarë të ndryshëm, përkatësisht bazë, optimist dhe të pafavorshëm. Në mospagim, pesha e atribuar skenarit fillestar është 50%, ndërsa 50% e mbetur u caktohet skenarit optimist dhe atij të pafavorshëm bazuar në peshat e tyre përkatëse;
- Për të ndërtuar peshat përkatëse që u atribuohen skenarëve optimistë dhe të pafavorshëm, u shqyrtua saktësia e parashikimeve të variablës shpjeguese (makro-variabla) e përdorur në analizën e regresionit, e marrë nga Komisioni Evropian në lidhje me ekonominë shqiptare. Qëllimi ishte të shqyrtohej vazhdimisht saktësia e parashikimit të një pale të tretë të pavarur, objektiviteti i së cilës nuk mund të vihet në dyshim.
- Komisioni Evropian ka lëshuar vazhdimisht parashikime për ekonominë shqiptare nga VF 2014 dhe më tej. Vëmendja u përqendrua në parashikimet e vjeshtës të lëshuara në nëntor të secilës periudhë fiskale, pasi saktësia e parashikimeve për të njëjtën periudhë fiskale (dmth. Viti fiskal që lidhet me lëshimin e botimit) është më e madhe (se çdo parashikim i mëparshëm p.sh. parashikimet e pranverës ose verës), pasi pjesa më e madhe e periudhës së përmendur tashmë ka kaluar;

Probabiliteti për mosshlyerje (PD)

Portofoli i huadhënies me shumicë

Është një vlerësim i probabilitetit të një huamarrësi për të mos paguar në një interval specifik kohor.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Probabiliteti për mosshlyerje (PD) (vazhdim)

Metodologjia e vlerësimit të PD-së për gjatë jetës, për portofolin e shitjeve me shumicë zbatohet për klientët që vlerësohen nga modelet e vlerësimit të Alpha Albania Bank që vlerësojnë një seri parametrash që mund të grupohen si më poshtë:

- Analiza financiare: Kapaciteti financiar i Huamarrësit (Treguesit e Likuiditetit, Borxhi ndaj të Ardhurave etj.)
- Analiza e konkurrencës: pozicioni krahasues i huamarrësit në tregun në të cilin operon, kryesisht në lidhje me konkurrentët e tij (kryesisht të zbatueshëm për debitorët e Bankës me shumicë)
- Të dhënat e sjelljes së debitorit aktual dhe historik ose ndaj Bankës ose ndaj palëve të treta (delikuentat, sjellja e ripagimit, etj.) dhe
- Karakteristikat cilësore të debitorit (menaxhim i fortë dhe i shëndoshë, trashëgimi menaxheriale, pajisje dhe mjete të përshtatshme, etj.)

Bazuar në deklaratën e mësipërme, metodologjia përbëhet nga:

- Krijimi i bashkimeve për detyruesit të vlerësuar nga modeli përkatës
- PD e vërejtur 12-mujore llogaritet për vlerësim

Qasja në vlerësimin e PD përgjatë jetës është bazuar në hapat e mëposhtëm:

- PD 12-mujore është pika fillestare e vlerësimit
- Shpërndarja e detyruesve në periudhën e rezultatit
- Rregullime makro në bazë të portofolit

Portofoli i huadhënies me pakicë

Është një vlerësim i probabilitetit të një huamarrësi për të mos paguar në një interval specifik kohor.

Për vlerësimin e probabilitetit të mospagimit, metodologjia përbëhet nga blloqet e mëposhtme:

- Krijimi i grupeve të ekspozimeve me profil të ngjashëm rreziku
- Grupet janë krijuar kryesisht bazuar në variablat e sjelljes në nivelin e llogarisë. Më konkretisht, portofoli është segmentuar në jo-risstrukturuar (i siguruar / pasiguar) dhe risstrukturuar. Grupi aktual është mjeti i zgjedhur për ndërtimin e bashkësive të dy segmenteve.
- PD e vërejtur 12-mujore llogaritet për bashkësi.

Vlerësimi i PD për gjatë jetës bazohet në hapat e mëposhtëm:

- PD e llogaritur 12-mujore është pika fillestare e vlerësimit të për gjatë jetës
- Performimi i një analize të mirë për secilin grup për të gjithë periudhën e rezultatit në dispozicion
- Modelimi i ndryshimeve të vëzhguara të përqindjes së kurbave historike ndërmjet periudhave
- Vlerësimi i përbërës të tërheqjes të secilit portofol sipas maturitetit të mbetur kontraktual
- Realizimi i llogaritjes përfundimtare 12-mujore në rritje dhe me fokus nga e ardhmja për pikën e vëzhgimit dhe grupin.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Ekspozimi në mospagim (EAD): Ekspozimi në mospagim është një vlerësim i shumës së ekspozimit në kohën e mospagimit duke marrë parasysh: (a) ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, përfshirë pagesat e kryegjësë dhe interesit; (b) përdorimi i pritshëm i kufijve të kredisë dhe (c) interesi i përlllogarit. Kufijtë e aprovuar të kredisë që nuk janë disbursuar plotësisht përfaqësojnë një ekspozim të mundshëm të kredisë dhe shndërrohen në një ekspozim kredie të barabartë me zotimet e miratuara të kredisë së pa tërhequr shumëzuar me një faktor të konvertimit të kredisë (FKK). Faktori i konvertimit të kredisë së ekspozimit të kredisë llogaritet bazuar në modelet statistikore. Periudha maksimale për të cilën llogariten humbjet e kredisë është maturimi i mbetur kontraktual i një instrumenti financiar përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore për të tërhequr më herët instrumentin financiar.

Humbja në rast mospagimi (LGD): Humbja në rast mospagimi është një vlerësim i humbjes që do të ndodhë nëse mospagimi ndodh në një kohë të caktuar. Ajo bazohet në diferencën midis flukseve të parave të gatshme kontraktuale dhe atyre që pritet të merren, përfshirë likuidimin e kolateralit dhe probabilitetin e shërimit të cilat bazohen në të dhëna historike. Për kreditë e pasiguruar, Humbja e Pritur e Vlerësuar në kohën e mospagimit, merr parasysh normat e pritshme të rimëkëmbjes të cilat ndryshojnë gjatë gjithë periudhës së rimëkëmbjes dhe probabilitetin e shërimit. Rikuperimet e pritshme nga kolateralët e prekshëm bazohen në inputet e mëposhtme: vlera më e fundit (e azhurnuar brenda vitit) e tregut të kolateralit, koha e nevojshme për likuidimin ose shitjen e kolateralit (varion nga 1 deri në 5 vjet në varësi të veprimit juridik statusi i huasë), vlera e pritshme e tregut në datën e likuidimit / shitjes bazuar në evolucionin e RRE / CRE, rikuperimet e pritshme përmes procesit të konfiskimit ose shitjes siç rrjedhin nga të dhënat historike të marra për bllokimet dhe shitjet e kolateralit. Flukset e pritshme të parave zbriten duke përdorur normën origjinale të interesit efektiv.

Rreziku Mjedisor dhe Social

Në kuadrin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë dhe Politikave të Kredisë është integruar vlerësimi i përputhshmërisë me parimet e një financimi me përgjegjësi mjedisore dhe sociale ndaj personave juridikë. Qëllimi kryesor është menaxhimi i rrezikut potencial që del nga operacionet e kredimarrësit që mund të lidhen me një dëmtim të mjedisit ose të shoqërisë, apo me ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë të një dëmtimi të tillë, duke pasur si rezultat një ndikim negativ në operacionet e biznesit dhe rezultatet financiare të Bankës. Në aspektin e menaxhimit të rrezikut të kredisë, Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjës për:

- monitorimin e rrezikut të kreditit për të siguruar përputhshmërinë me strategjinë e rrezikut të kredisë dhe politikat, si dhe efektivitetin e masave kundër dhe veprimet e menaxhimit;
- identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të kredisë ekzistues dhe të mundshëm të natyrshëm në produkte/aktivitete;
- vlerësimin e niveleve të zhvlerësimit dhe dispozitat rregullatore për portofolin e kredive;
- raportimin tek Komiteti i Rrezikut për problemet e identifikuara apo të ardhshme që lidhen me ndryshimet në profilin e tanishëm apo të pritshëm të rrezikut.

Gjithashtu Banka kryen dy herë në vit prova të stresit në mënyrë që të vlerësojë dobësinë e saj ndaj ngjarjeve të mundshme të ardhshme siç janë ndryshimet në mjedisin ekonomik apo financiar të cilat mund të kenë ndikime të pafavorshme në ekspozimet e kredisë dhe aftësinë e Bankës për t'i përballuar këto ndryshime. Rezultatet e këtyre provave mund të përdoren për të optimizuar më tej monitorimin e portofolit të rrezikuar. Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë të zhvlerësimit në përputhje me parimet e përgjithshme dhe metodologjinë e përcaktuar në SNK 39 dhe udhëzimin përkatës të implementimit si edhe Parimet e Politikës së Provigjonimit të Grupit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Balancat me Bankën Qëndrore	12	6,716,816	6,989,744
Kredi drejt institucioneve financiare	13	11,830,779	14,088,526
Kredi dhe paradhënie klientëve	15	33,585,947	35,007,564
Investime në letra me vlerë VDATGJ		19,985,089	16,249,370
Investime në letra me vlerë VDPFH		-	1,224,850
		72,118,631	73,560,054
Angazhime për kredi të patërhequra	29	1,906,264	1,244,347
Garanci dhënë në favor të klientëve	29	686,539	583,205
		2,592,803	1,827,552
Ekspozimi total, pas zhvlerësimit		74,711,434	75,387,606

Kredi me vonesë

Një aktiv financiar është me vonesë nëse borxhi i palës tjetër është me vonesë më shumë se një (1) ditë, sipas specifikave teknike 'Projektligji final mbi prapen e materialitetit për detyrimet e kredisë në vonesë' lëshuar nga EBA më 28.9.2016. Shuma që duhet paguar konsiderohet si shuma e principalit, interesave dhe pagesave / komisioneve që është mbi një ditë për shkak të nivelit të llogarisë.

Ekspozim i modifikuar

Një ekspozim konsiderohet si i **Modifikuar** nëse ka një ndryshim thelbësor në termat fillestare kontraktuale duke garantuar terma më të favorshëm (**Lëshim**) ose rifinancim të pjesshëm a të plotë të borxhit aktual të mbajtur (**Rifinancim**) të Huamarrësit me **Vështirësi Financiare**.

Vështirësi financiare

Vështirësi financiare konsiderohet situata në të cilën huamarrësit e kanë të pamundur të përputhen ose janë gati për tu përballur me vështirësi në shlyerjen e detyrimeve kreditore sipas skedulit aktual të shlyerjes së huasë për shkak të statusit të tyre financiar.

Mundësia për Mospagim (MPM)

Një ekspozim përcaktohet si ekspozim me "Mundesine per Mospagim " kur gjendet në më pak se 90 ditë vonesë dhe Banka vlerëson se huamarrësi nuk ka probabilitet të përmbushi plotësisht detyrimet e tij kreditore pa likuiduar kolateralin, pavarësisht ekzistencës të ndonjë shume në vonesë ose të numrit të ditëve në vonesë, me përjashtim të rasteve kur kolaterale të jenë pjesë e zinxhirit tregtar dhe prodhues të huamarrësit.

Kredi jo performuese

Një kredi konsiderohet jo-performuese nëse plotësohet një prej kushteve të mëposhtme:

- Ekspozimi është i vonuar prej më shumë se 90 ditë (JP);
- Një ekspozim ndaj të cilit janë ndërmarrë nga Banka veprime ligjore(JP);
- Ekspozimi klasifikohet si i Modifikuar Jo performues, sipas përcaktimit në Rregulloren e Implementimit (EU) 227/9.1.2015,
- Kredimarrësi është vlerësuar si i pamundur për të paguar;

Në portofolin bankar të korporatave, kur huamarrësi ka një ekspozim më shumë se 90 ditë në vonesë dhe vlera e ekspozimit tejkalon 20% të ekspozimit total të huamarrësit, atëherë të gjitha ekspozimet e huamarrësit konsiderohen jo performuese (Efekti i Tërheqjes).

Ekspozimi ndaj mospagimit

Një ekspozim konsiderohet si i **mospaguar** kur plotësohen kriteret e specifikuara nga perkufizimi i ekspozimeve jo performuese.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet të ardhurat nga interest e huave për vitin 2020 dhe 2019 sipas fazave të SNRF 9.

					Totali i të ardhurave nga interesi
2020	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	
Huadhënie për individë	559,838	77,405	29,756	-	666,999
Huadhënie për korporata	448,308	136,947	88,437	-	673,692
Sektori publik	39,725	-	-	-	39,725
Totali i të ardhurave nga interesi	1,047,871	214,352	118,193	-	1,380,416
					Totali i të ardhurave nga interesi
2019	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	
Huadhënie për individë	599,871	91,729	40,966	-	732,566
Huadhënie për korporata	513,827	86,739	89,829	-	690,395
Sektori publik	52,437	1,730	-	-	54,167
Totali i të ardhurave nga interesi	1,166,135	180,198	130,795		1,477,128

Kreditë e çregjistruara

Kreditë e çregjistruara përcaktohen si reduktimi kontabël i një borxhi, që nuk nënkupton heqjen dorë nga kërkesa ligjore kundër debitorëve dhe, për rrjedhojë, borxhi mund të ringjallet. Propozimet për heqjen dorë (plotësisht ose pjesërisht) nga borxhet mund të dorëzohen në komisionin kompetent me kusht që të jenë plotësuar sa më poshtë:

- Marrëveshjet relevante me klientët të kenë përfunduar.
- Urdhër pagesat të jenë lëshuar kundrejt palëve përgjegjëse.
- Procedura për regjistrimin e barrës së detyrueshme të ketë filluar.
- Të paktën një nga pasuritë e paluajtshme të jetë në ankand, të radhitura sipas kërkesave të privilegjuara (përmes listës së kreditorëve prioritarë) dhe, si rrjedhojë, që humbjet e mundshme të Bankës të finalizohen.
- Dispozita të barabarta për zhvlerësim të paktën gjatë tremujorit që paraprin një nga propozimet.

Kredi të çregjistruara	Hipotekore	Konsumatore	Karta kredi	Korporata	Totali
Më 1 janar 2019	395,716	191,496	74,954	5,147,172	5,809,338
Kredi të çregjistruara	78,628	40,561	4,477	348,675	472,341
Rikuperimet	(23,300)	(10,551)	(1,412)	(34,834)	(70,097)
Më 31 dhjetor 2019	451,044	221,506	78,019	5,461,013	6,211,582
Kredi të çregjistruara	102,292	30,794	1,975	235,092	370,153
Rikuperimet	(1,213)	(7,621)	(901)	(23,200)	(32,935)
Më 31 dhjetor 2020	552,123	244,679	79,094	5,672,904	6,548,800

Banka monitoron vazhdimisht portofolin e kredive të çregjistruara. Banka ka rikuperuar 32,935 mijë Lek gjatë vitit 2020 (2019: 70,097 mijë Lek).

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Kreditë e çregjistruara

Kreditë e çregjistruara përkufizohen si një zvogëlim i borxhit, si rezultat i një vendimi ose marrëveshje ligjërishit detyruese (vendim gjyqi, marrëveshje kontraktuale etj.), e cila nuk është më e kërkueshme dhe rrjedhimisht, konsiderohet në mënyrë përfundimtare si e parikuperueshme, çka do të thotë se Banka në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme heq dorë nga e drejta për të kërkuar borxhin e fshirë, përveçse nëse (në rast të rënies dakord) konstatohet se termat e vendosur prej vendimit apo marrëveshjes së sipërpërmendur janë shkelur. Nga shuma totale e kredive të çregjistruara gjatë 2020 prej 370,153 mijë Lek (2019: 472,341 mijë Lek), shuma prej 131,256 mijë Lek përfaqëson kredi të çregjistruara.

Kolaterali

Banka mban kolaterale kundrejt huave dhe paradhënies dhënë klientëve në formën e hipotekave mbi pasuritë e paluajtshme, të drejta të tjera të regjistruara mbi aktive, si dhe garanci. Përlllogaritja e vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit në momentin e huadhënies, dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme sipas llojit të kolateralit. Përgjithësisht nuk mbahen kolaterale për hua dhënë Bankave, me përjashtim të rastit kur letrat me vlerë janë të mbajtura si pjesë e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe të aktivitetit të huamarrjes së letrave me vlerë. Një vlerësim i vlerës si drejtë të kolateraleve dhe titujve të tjerë garantues të mbajtur përkundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve paraqitet më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Huadhënie ndaj korporatave	14,670,295	16,288,860
Prona	12,048,528	13,185,614
Kolateral financiar	116,549	27,946
Kolaterale të tjerë	2,505,218	3,075,300
Huadhënie me pakicë	11,735,858	10,853,000
Prona	11,479,227	10,538,364
Kolateral financiar	212,570	263,084
Kolaterale të tjerë	44,061	51,552
Sektori publik	717,460	1,436,886
Prona	-	-
Kolateral financiar	717,460	1,436,886
Kolaterale të tjerë	-	-
Totali	27,123,613	28,578,746

Nën "Kolaterali financiar", Banka përfshin para të gatshme (para në llogari bankare), letra me vlerë (si borxh dhe kapital) dhe pretendime kredie (shuma që u detyrohen bankave).

Titulli "Kolateral tjetër" përfshin të gjitha kolateralët të cilët nuk janë "Kolateral i pasurive të paluajtshme" dhe "Kolateral financiar" ku llojet me bilancin më të lartë janë peng mbi të arkëtueshmet dhe inventarin e kontratës (~ 60%) dhe hipotekën detare (~ 20%).

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Përcaktimi sipas vendndodhjes

Përqendrimi sipas vendndodhjes për huatë dhe paradhëniet matet bazuar në vendndodhjen e subjektit që mban aktivin, i cili ka një korrelacion të lartë me vendndodhjen e huamarrësit. Përqendrimi sipas vendndodhjes për letrat me vlerë të tregtueshme dhe të investimit matet bazuar në vendndodhjen e lëshuesit të letrës me vlerë.

	2020			2019		
	Shqipëri	Shtete të tjera	Totali	Shqipëria	Shtete të tjera	Totali
Mjete monetare dhe balanca me Bankën e Qëndrore	6,716,816	-	6,716,816	6,989,744	-	6,989,744
Hua dhe Paradhënie për institucionet financiare	371,098	11,459,681	11,830,779	1,081,409	13,007,117	14,088,526
Hua dhe Paradhënie për Klientët	30,717,200	2,868,747	33,585,947	31,716,806	3,290,758	35,007,564
Instrumente të mbajtura me VDATGj	12,567,177	7,417,911	19,985,088	10,939,443	5,309,927	16,249,370
Instrumente të mbajtura me VDPFH	-	-	-	-	1,224,850	1,224,850
Totali	50,372,292	21,746,339	72,118,631	50,727,402	22,832,652	73,560,054

Kategoria 'Shtete të tjera' përfaqëson palë të vendosura në shtete Europiane. Shiko shënimin 14 për më tepër detaje rreth instrumenteve të mbajtura VDATGj me shtete të tjera.

Aktivitet financiar të vlefshme për shitje në Shqipëri, përfaqësojnë bono dhe obligacione thesari të lëshuara nga Qeveria Shqiptare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Përcaktimi sipas industrisë

Shumat e paraqitura sipas përqendrimit nga industria paraqiten në bruto.

<i>Huadhënie dhe paradhënie konsumatorëve</i>	2020	% në total	2019	% në total
Tregti me shumicë dhe pakicë	5,600,343	16%	6,028,576	17%
Kredi hipotekore	9,413,781	27%	8,694,843	24%
Prodhimtari	5,328,803	15%	6,971,629	19%
Karta kredie dhe konsumatore	4,838,344	14%	4,381,747	12%
Spektori publik	4,270,654	12%	5,606,001	15%
Sektore të tjera	1,862,263	5%	677,756	2%
Shërbime	829,989	2%	1,585,881	4%
Transport	783,342	2%	318,158	1%
Transport mallrash	766,763	2%	1,032,941	3%
Hoteleri/Turizëm	532,832	2%	333,260	1%
Ndërtim	438,739	1%	745,124	2%
Zhvillim urbanistikë	154,184	-%	-	-%
Kredi biznesi për individë	58,294	-%	101,079	-%
	34,878,331	100%	36,476,995	100%

Përcaktimi sipas industrisë

<i>Zëra jashtë bilancit</i>	2020	% në total	2019	% në total
Tregti me shumicë dhe pakicë	1,111,450	43%	552,799	30%
Prodhimtari	752,528	29%	450,259	25%
Karta kredie dhe konsumatore	566,481	22%	642,492	35%
Sektore të tjera	89,259	3%	57,770	3%
Ndërtim	23,040	1%	66,524	4%
Institucione financiare dhe shërbime të tjera financiare	21,429	1%	10,864	1%
Transport	14,415	1%	30,571	2%
Hoteleri/Turizëm	13,407	1%	13,489	1%
Kredi biznesi për individë	794	-%	2,783	-%
	2,592,803	100%	1,827,551	100%

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e vlerësimit kreditor

Analiza e vlerësimit për tepricat me Bankën e Shqipërisë, Kreditë dhe paradhëniet për Bankat, dhe Letrat me Vlerë për 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është paraqitur më poshtë:

Vlerësimi	2020					2019				
	Banka qendrore	Detyrimet nga bankat	VDATGj	VDPFH	Totali	Banka qendrore	Detyrimet nga bankat	VDATGj	VDPFH	Totali
AAA										
AA+	-	-	-	-	-	-	-	-	1,096,300	1,096,300
A-										
BBB+		2,917,963	-		2,917,963	-	2,271,490	-		2,271,490
BBB	-		-	-	-	-	1,313,850	-	-	1,313,850
BBB-		2,096,844	1,389,478		3,486,322			1,378,141		1,378,140.88
B+	6,716,816	-	13,201,605		19,918,421	6,989,743		11,550,321		18,540,064
B-		6,444,874			6,444,874		487,080			487,080
B							8,921,720			8,921,720
BB			126,031		126,031					
BB+										
BB-			3,166,141		3,166,141			1,962,229		1,962,229
CCC										
Unrated		371,098	2,101,834		2,472,932		1,094,386	1,358,679	128,550	2,581,615
	6,716,816	11,830,779	19,985,089	-	36,422,048	6,989,743	14,088,526	16,249,370	1,224,850	38,552,489

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Huatë sipas fazimit të SNRF 9 (me dhe pa vonesa)

Tabelat e mëposhtme paraqesin huatë me dhe pa ditëvonesa, të matura me koston e amortizuar, sipas fazimit të SNRF 9. Nuk ka asnjë hua për të raportuar të cilat ishin zhvlerësuar në blerjen / origjinën e tyre (POCI) ose matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Tabela e mëposhtme paraqet huatë me dhe pa ditëvonesa, të matura me koston e amortizuar, sipas SNRF 9 në fazën 1 në 31 Dhjetor, 2020 dhe 31 Dhjetor 2019. Ju lutemi referojuni shënimit Huatë sipas fazimit të SNRF 9 më poshtë për barazimin e kredive totale në fazën 1.

	Kreditë e matura në kosto të amortizuara (KA)				
	Faza 1				
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2020					
Huadhënie individ	9,615,371	2,123,996	11,739,368	56,835	11,682,533
Hipotekore	6,238,607	1,368,749	7,607,357	7,931	7,599,426
Konsumatore	3,235,057	744,907	3,979,964	45,712	3,934,252
Karta Kredie	125,696	4,149	129,845	3,187	126,658
Të tjera (përfsh. SBL)	16,011	6,191	22,202	5	22,197
Huadhënie korporate	9,852,926	241,782	10,094,708	211,879	9,882,829
E madhe	8,088,099	38,583	8,126,682	182,475	7,944,207
SME	1,764,827	203,199	1,968,026	29,404	1,938,622
Sektori publik	4,242,991	-	4,242,991	23,877	4,219,114
Greqi	-	-	-	-	-
Shqipëri	4,242,991	-	4,242,991	23,877	4,219,114
Totali	23,711,288	2,365,778	26,077,067	292,591	25,784,476

	Kreditë e matura në kosto të amortizuara (KA)				
	Faza 1				
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2019					
Huadhënie individ	8,171,157	2,453,340	10,624,497	58,295	10,566,202
Hipotekore	5,105,973	1,641,624	6,747,597	9,528	6,738,069
Konsumatore	2,902,486	780,514	3,683,000	45,828	3,637,172
Karta Kredie	142,410	9,824	152,234	2,911	149,323
Të tjera (përfsh. SBL)	20,288	21,378	41,666	28	41,638
Huadhënie korporate	9,407,622	1,675,578	11,083,200	209,017	10,874,183
E madhe	8,489,401	1,156,602	9,646,003	196,152	9,449,851
SME	918,221	518,976	1,437,197	12,865	1,424,332
Sektori publik	5,566,675	-	5,566,675	27,846	5,538,829
Greqi	-	-	-	-	-
Shqipëri	5,566,675	-	5,566,675	27,846	5,538,829
Totali	23,145,454	4,128,918	27,274,372	295,158	26,979,214

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet kreditë e papaguara dhe ato të papaguara, të matura me kosto të amortizuara, për SNRF 9 Faza 2 me 31 Dhjetor, 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

Ju lutemi referojuni shënimit Huatë nga SNRF 9 më poshtë për barazimin e kredive totale, faza 2.

Kreditë e matura në kosto të amortizuara (KA)					
Faza 2					
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2020					
Huadhënie individ	341,295	1,076,192	1,417,488	86,432	1,331,056
Hipotekore	299,001	685,808	984,809	20,515	964,294
Konsumatore	33,953	367,761	401,715	63,221	338,494
Karta Kredie	1,807	4,707	6,514	2,510	4,004
Të tjera (përfsh. SBL)	6,534	17,916	24,450	186	24,264
Huadhënie korporate	3,071,060	1,091,990	4,163,050	165,013	3,998,037
E madhe	2,869,496	894,710	3,764,206	158,587	3,605,619
SME	201,564	197,280	398,844	6,426	392,418
Totali	3,412,355	2,168,182	5,580,538	251,445	5,329,093

Kreditë e matura në kosto të amortizuara (KA)					
Faza 2					
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2019					
Huadhënie individ	372,207	985,037	1,357,244	65,574	1,291,670
Hipotekore	318,503	756,162	1,074,665	30,029	1,044,636
Konsumatore	37,186	222,044	259,230	32,887	226,342
Karta Kredie	2,091	5,782	7,873	2,369	5,504
Të tjera (përfsh. SBL)	14,427	1,049	15,476	289	15,188
Huadhënie korporate	3,338,305	1,314,971	4,653,276	173,095	4,480,181
E madhe	3,247,176	1,078,188	4,325,364	172,230	4,153,134
SME	91,129	236,783	327,912	865	327,047
Totali	3,710,512	2,300,008	6,010,520	238,669	5,771,851

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet huatë me dhe pa ditëvonesa, të matura me kosto të amortizuar, për SNRF 9 Faza 3 me 31 Dhjetor, 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

Ju lutemi referojuni shënimit Huatë nga SNRF 9 më poshtë për barazimin e kredive totale faza 3.

Kreditë e matura në kosto të amortizuara (KA)					
Faza 3					
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2020					
Huadhënie individ	80,103	1,073,463	1,153,565	470,960	682,605
Hipotekore	71,035	750,581	821,615	239,082	582,533
Konsumatore	9,068	278,915	287,983	205,397	82,586
Karta Kredie	-	32,324	32,324	21,544	10,780
Të tjera (përfsh. SBL)	-	11,643	11,643	4,937	6,706
Huadhënie korporate	928,980	1,060,636	1,989,616	199,843	1,789,773
E madhe	715,480	747,285	1,462,765	142,975	1,319,790
SME	213,500	313,351	526,851	56,868	469,983
Totali	1,009,083	2,134,099	3,143,181	670,803	2,472,378

Loans measured at Amortised Cost (AC)					
Stage 3					
	Pa ditëvonesa	Me ditëvonesa	Totali	Zbritje	Sasia neto totale
31 dhjetor 2019					
Huadhënie individ	26,835	1,169,092	1,195,928	548,664	647,265
Hipotekore	17,016	855,564	872,581	319,974	552,606
Konsumatore	9,819	243,178	252,997	179,300	73,697
Karta Kredie	-	26,414	26,414	18,133	8,283
Të tjera (përfsh. SBL)	-	43,936	43,936	31,257	12,679
Huadhënie korporate	378,327	1,552,099	1,930,425	321,190	1,609,234
E madhe	268,632	1,128,119	1,396,751	252,733	1,144,017
SME	109,695	423,980	533,674	68,457	465,217
Totali	405,162	2,721,191	3,126,353	869,854	2,256,499

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Kreditë sipas fazimit të SNRF 9

Tabela e mëposhtme paraqet kreditë, të matura me koston e amortizuar, të klasifikuara sipas fazave të SNRF 9 më 31 dhjetor, 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

2020				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Kreditë	26,077,067	5,580,538	3,143,181	34,800,786
Zbritja	292,591	251,445	670,803	1,214,839
Totali	25,784,476	5,329,093	2,472,378	33,585,947
2019				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Kreditë	27,274,372	6,010,520	3,126,353	36,411,245
Zbritja	295,158	238,669	869,854	1,403,681
Totali	26,979,214	5,771,851	2,256,499	35,007,564

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Kreditë sipas cilësisë së kredisë dhe fazimit të SNRF 9

Tabelat e mëposhtme paraqesin huatë e matura me kosto të amortizuara sipas fazimit të SNRF 9 dhe cilësisë së kredisë për portofolin e individëve. Nuk ka asnjë hua për të raportuar të cilat ishin zhvlerësuar në blerjen / origjinën e tyre (POCI) ose matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

31 dhjetor, 2020	Hua të matura me kosto të amortizuara (KA)			
	HPK 12 mujore	HPK e përjetshme – Kredi jo e zhvlerësuar	HPK e përjetshme – Kredi e zhvlerësuar	Totali
Hipotekore				
E fortë	7,607,357	984,809	-	8,592,166
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	821,615	821,615
Totali i vlerës bruto	7,607,357	984,809	821,615	9,413,781
Provigjonimi i humbjes	7,931	20,515	239,082	267,528
Vlera e mbartur	7,599,426	964,294	582,533	9,146,253
Konsumatore				
E fortë	3,979,964	401,715	-	4,381,679
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	287,983	287,983
Totali i vlerës bruto	3,979,964	401,715	287,983	4,669,662
Provigjonimi i humbjes	45,712	63,221	205,397	314,330
Vlera e mbartur	3,934,252	338,494	82,586	4,355,332
Karta Krediti				
E fortë	129,845	6,514	-	136,359
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	32,324	32,324
Totali i vlerës bruto	129,845	6,514	32,324	168,683
Provigjonimi i humbjes	3,187	2,510	21,544	27,241
Vlera e mbartur	126,658	4,004	10,780	141,442
Të tjera (përfshirë SBL)				
E fortë	22,202	24,450	-	46,652
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	11,643	11,643
Totali	22,202	24,450	11,643	58,295
Provigjonimi i humbjes	5	186	4,937	5,128
Vlera e mbartur	22,197	24,264	6,706	53,167

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

Më 31 dhjetor 2019	Hua të matura me kosto të amortizuar (KA)			
	HPK 12- mujore	HPK e përjetshme Kredi jo e zhvlerësuar	HPK e përjetshme Kredi e zhvlerësuar	Totali
Hipotekore				
E fortë	6,747,597	1,074,665	-	7,822,262
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	872,581	872,581
Totali i vlerës bruto	6,747,597	1,074,665	872,581	8,694,843
Provigjonimi i humbjes	9,528	30,029	319,974	359,531
Vlera e mbartur	6,738,069	1,044,636	552,607	8,335,312
Konsumatore	-	-	-	-
E fortë	3,682,999	259,230	-	3,942,229
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	252,997	252,997
Totali i vlerës bruto	3,682,999	259,230	252,997	4,195,226
Provigjonimi i humbjes	45,828	32,888	179,300	258,016
Vlera e mbartur	3,637,171	226,342	73,697	3,937,210
Karta Krediti	-	-	-	-
E fortë	152,234	7,873	-	160,107
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	26,414	26,414
Totali i vlerës bruto	152,234	7,873	26,414	186,521
Provigjonimi i humbjes	2,911	2,369	18,132	23,412
Vlera e mbartur	149,323	5,504	8,282	163,109
Të tjera (përfshirë SBL)	-	-	-	-
E fortë	41,666	15,477	-	57,143
E kënaqshme	-	-	-	-
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	-	-	-	-
Mospagim	-	-	43,936	43,936
Totali	41,666	15,477	43,936	101,079
Provigjonimi i humbjes	28	289	31,257	31,574
Vlera e mbartur	41,638	15,188	12,679	69,505

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet kreditë e matura me kosto të amortizuar sipas fazimit të SNRF 9 dhe cilësisë së kredisë për portofolin e korporatave në 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

31 Dhjetor 2020	Hua të matura me kosto të amortizuar (KA)			
	HPK 12 mujore	HPK e përjetshme – Kredi jo e zhvlerësuar	HPK e përjetshme – Kredi e zhvlerësuar	Totali
Korporatë				
E fortë	1,760,056	40,646	0	1,800,702
E kënaqshme	6,238,031	2,999,096	0	9,237,127
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	128,595	724,463	0	853,058
Mospagim	0	0	1,462,765	1,462,765
Totali i vlerës bruto	8,126,682	3,764,205	1,462,765	13,353,652
Provizionimi i humbjes	182,475	158,587	142,975	484,037
Vlera e mbartur	7,944,207	3,605,618	1,319,790	12,869,615
Korporatë e vogël – e mesme				
E fortë	81,988	-	-	81,988
E kënaqshme	1,595,769	108,285	-	1,704,054
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	290,270	290,560	-	580,830
Mospagim	-	-	526,851	526,851
Totali i vlerës bruto	1,968,027	398,845	526,851	2,893,723
Provizionimi i humbjes	29,404	6,426	56,868	92,698
Vlera e mbartur	1,938,623	392,419	469,983	2,801,025
Sektori publik në Shqipëri	-	-	-	-
E kënaqshme	4,242,991	-	-	4,242,991
Total	4,242,991	-	-	4,242,991
Provizionimi i humbjes	23,877	-	-	23,877
Vlera e mbartur	4,219,114	-	-	4,219,114
Letra garancie, letra krediti dhe garanci të tjera				
E fortë	34,937	-	-	34,937
E kënaqshme	645,859	-	-	645,859
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	5,743	-	-	5,743
Mospagim	-	-	-	-
Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë	686,539	-	-	686,539
Provizionimi i humbjes	8,649	-	-	8,649
Vlera e mbartur (provizion)	677,890	-	-	677,890
Marrëveshjet e hapura dhe kufijtë e kredisë	-	-	-	-
E fortë	627,316	13,505	-	640,821
E kënaqshme	1,192,087	60,536	-	1,252,623
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	4,453	8,367	-	12,820
Mospagim	-	-	-	-
Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë	1,823,856	82,408	-	1,906,264
Provizionimi i humbjes	-	-	-	-
Vlera e mbartur	1,823,856	82,408	-	1,906,264

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

31 Dhjetor 2019	Hua të matura me kosto të amortizuar (KA)			
	HPK 12 mujore	HPK e përjetshme – Kredi jo e zhvlerësuar	HPK e përjetshme – Kredi e zhvlerësuar	Totali
Korporatë				
E fortë	2,063,442	48,399	-	2,111,841
E kënaqshme	7,293,916	1,809,792	-	9,103,708
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	288,645	2,467,173	-	2,755,818
Mospagim	-	-	1,396,751	1,396,751
Totali i vlerës bruto	9,646,003	4,325,364	1,396,751	15,368,118
Provizionimi i humbjes	196,153	172,229	252,733	621,115
Vlera e mbartur	9,449,850	4,153,135	1,144,018	14,747,003
Korporatë e vogël – e mesme				
E fortë	45,357	-	-	45,357
E kënaqshme	1,119,024	128,291	-	1,247,315
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	272,816	199,621	-	472,437
Mospagim	-	-	533,674	533,674
Totali i vlerës bruto	1,437,197	327,912	533,674	2,298,783
Provizionimi i humbjes	12,865	865	68,457	82,187
Vlera e mbartur	1,424,332	327,047	465,217	2,216,596
Sektori publik në Shqipëri				
E kënaqshme	5,566,675	-	-	5,566,675
Total	5,566,675	-	-	5,566,675
Provizionimi i humbjes	27,846	-	-	27,846
Vlera e mbartur	5,538,829	-	-	5,538,829
Letra garancie, letra krediti dhe garanci të tjera				
E fortë	11,941	-	-	11,941
E kënaqshme	540,535	-	-	540,535
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	30,729	-	-	30,729
Mospagim	-	-	-	-
Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë	583,205	-	-	583,205
Provizionimi i humbjes	-	-	-	-
Vlera e mbartur (provizion)	583,205	-	-	583,205
Marrëveshjet e hapura dhe kufijtë e kredisë				
E fortë	716,034	14,844	-	730,878
E kënaqshme	348,719	556	-	349,275
Në listë vëzhgimi (rrezik më i lartë)	73,713	90,480	-	164,193
Mospagim	-	-	-	-
Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë	1,138,466	105,880	-	1,244,346
Provizionimi i humbjes	-	-	-	-
Vlera e mbartur	1,138,466	105,880	-	1,244,346

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabelat e mëposhtme paraqesin analizën e vjetërsisë sipas fazimit të SNRF dhe linjës së produktit e shprehur në shuma neto për portofolin e individëve më 31 Dhjetor, 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

		Huatë e matura me kosto të amrotizuar (KA)							
		Hua tregtare							
31 Dhjetor 2020	Hipotekore				Konsumatore				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	
Aktuale	6,234,280	294,187	69,447	6,597,914	3,212,433	32,423	7,052	3,251,908	
1 - 30 ditë	1,365,146	144,840	55,436	1,565,422	721,818	40,297	14,963	777,078	
31 - 60 ditë	-	342,448	96,658	439,106	-	141,029	2,364	143,393	
61 - 90 ditë	-	182,820	115,090	297,910	-	124,744	14,253	138,997	
91 - 180 ditë	-	-	20,580	20,580	-	-	18,756	18,756	
181 - 360 ditë	-	-	28,223	28,223	-	-	13,796	13,796	
> 360 ditë	-	-	197,100	197,100	-	-	11,402	11,402	
Totali	7,599,426	964,295	582,534	9,146,255	3,934,251	338,493	82,586	4,355,330	
Vlera e kolateralit	7,556,859	974,321	721,768	9,252,948	2,129,906	222,518	76,433	2,428,857	

		Huatë e matura me kosto të amrotizuar (KA)							
		Hua tregtare							
31 Dhjetor 2020	Karta Krediti				Të tjera (përfsh. SBL)				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	
Aktuale	122,939	1,218	-	124,157	16,008	6,499	-	22,507	
1 - 30 ditë	3,720	229	-	3,949	6,188	-	1,760	7,948	
31 - 60 ditë	-	2,124	-	2,124	-	5,045	1,838	6,883	
61 - 90 ditë	-	433	-	433	-	12,721	-	12,721	
91 - 180 ditë	-	-	566	566	-	-	-	-	
181 - 360 ditë	-	-	10,213	10,213	-	-	3,104	3,104	
> 360 ditë	-	-	-	-	-	-	4	4	
Totali	126,659	4,004	10,779	141,442	22,196	24,265	6,706	53,167	
Vlera e kolateralit	-	-	-	-	22,202	24,450	7,402	54,054	

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

		Huatë e matura me kosto të amrotizuar (KA)							
		Hua tregtare							
31 Dhjetor 2019	Hipotekore				Konsumatore				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	
Aktuale	5,102,139	312,892	12,849	5,427,880	2,883,676	33,726	4,921	2,922,323	
1 - 30 ditë	1,635,930	224,768	74,034	1,934,732	753,495	20,801	11,655	785,951	
31 - 60 ditë	-	357,686	136,841	494,527	-	93,064	14,338	107,402	
61 - 90 ditë	-	149,291	83,804	233,094	-	78,752	8,240	86,992	
91 - 180 ditë	-	-	4,873	4,873	-	-	8,647	8,647	
181 - 360 ditë	-	-	16,019	16,019	-	-	11,575	11,575	
> 360 ditë	-	-	224,187	224,187	-	-	14,320	14,320	
Totali	6,738,069	1,044,636	552,606	8,335,312	3,637,171	226,342	73,697	3,937,210	
Vlera e kolateralit	6,697,464	1,060,904	738,408	8,496,776	2,046,839	162,435	69,267	2,278,540	

		Huatë e matura me kosto të amrotizuar (KA)							
		Hua tregtare							
31 Dhjetor 2019	Karta Krediti				Të tjera (përfsh. SBL)				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	
Aktuale	140,139	1,607	-	141,747	20,260	14,139	-	34,399	
1 - 30 ditë	9,184	140	-	9,323	21,378	-	203	21,581	
31 - 60 ditë	-	2,663	-	2,663	-	1,049	3,855	4,904	
61 - 90 ditë	-	1,094	-	1,094	-	-	2,072	2,072	
91 - 180 ditë	-	-	408	408	-	-	-	-	
181 - 360 ditë	-	-	7,874	7,874	-	-	-	-	
> 360 ditë	-	-	-	-	-	-	6,549	6,549	
Totali	149,323	5,504	8,282	163,108	41,638	15,188	12,679	69,506	
Vlera e kolateralit	-	-	-	-	41,666	15,477	20,541	77,683	

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabelat e mëposhtme paraqesin analizën e vjetërsisë sipas fazimit të SNRF dhe linjës së produktit e shprehur në shuma neto për portofolin e korporatave më 31 Dhjetor, 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

ME KOSTO TË AMORTIZUAR								
Hua Korporata								
31 Dhjetor 2020	Të mëdha				Të vogla – të mesme			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Aktuale	7,906,398	2,760,126	713,805	11,380,329	1,740,114	198,202	201,611	2,139,927
1 - 30 ditë	37,809	781,126	194,270	1,013,205	198,508	135,740	43,325	377,573
31 - 60 ditë	-	18,401	47,765	66,166	-	20,686	1,378	22,064
61 - 90 ditë	-	70,932	72,711	152,464	-	37,791	25,371	63,162
91 - 180 ditë	-	-	8,821	8,821	-	-	45,508	45,508
181 - 360 ditë	-	-	62,350	62,350	-	-	67,079	67,079
> 360 ditë	-	-	195,100	195,100	-	-	85,711	85,711
Totali	7,944,207	3,630,585	1,319,789	12,869,614	1,938,622	392,419	469,983	2,801,024
Vlera e kolateralit	7,169,708	3,585,199	1,120,683	11,875,590	1,880,958	394,521	519,226	2,794,705

ME KOSTO TË AMORTIZUAR				
31 Dhjetor 2020	Sektori Publik			
	Shqipëri			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Aktuale	4,219,114	-	-	4,219,114
Totali	4,219,114	-	-	4,219,114
Vlera e kolateralit	717,460	-	-	717,460

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

ME KOSTO TË AMORTIZUAR

Hua Korporata								
31 Dhjetor 2019	Të mëdha				Të vogla – të mesme			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Aktuale	8,304,888	3,098,522	237,147	11,640,557	910,147	91,112	104,693	1,105,952
1 - 30 ditë	1,144,964	966,520	117,127	2,228,611	514,185	95,886	17,066	627,137
31 - 60 ditë	-	60,970	95,793	156,763	-	114,557	19,623	134,180
61 - 90 ditë	-	27,122	175,326	202,448	-	25,492	83,761	109,253
91 - 180 ditë	-	-	207,533	207,533	-	-	83,666	83,666
181 - 360 ditë	-	-	49,442	49,442	-	-	47,611	47,611
> 360 ditë	-	-	261,649	261,649	-	-	108,798	108,798
Totali	9,449,852	4,153,134	1,144,017	14,747,003	1,424,332	327,047	465,218	2,216,597
Vlera e kolateralit	8,425,503	4,224,119	1,391,108	14,040,730	1,395,598	327,327	525,206	2,248,131

ME KOSTO TË AMORTIZUAR

31 Dhjetor 2019

Sektori Publik				
Shqipëri				
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali
Aktuale	5,538,829	-	-	5,538,829
Totali	5,538,829	-	-	5,538,829
Vlera e kolateralit	1,436,886	-	-	1,436,886

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në LEK'000 përveç nëse thuhet ndryshe)

5A. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

